



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT K R Y E T A R I

Nr.243/7 Prot.

Tiranë, më 29.06.2016

### V E N D I M

**Nr. 69, Datë 29.06.2016**

**PËR  
EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË USHTRUAR NË  
BASHKINË SHIJAK "MBI AUDITIMIN E LIGJSHMËRISË DHE  
RREGULLSHMËRISË FINANCIARE"**

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit Juridik, Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të Auditimit të mësipërm, në mbështetje të neneve 10, 15 dhe 30, të ligjit 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit",

### V E N D O S A:

**I.** Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit "Për auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare" të ushtruar në Bashkinë Shijak, për periudhën nga data 01.01.2014 deri më datë 31.12.2015.

**II.** Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

**A. MASA ORGANIZATIVE.**

**1. Gjetje nga auditimi:** Në Bashkinë Shijak, për aktivitetin ekonomik financiar të periudhës 01.01.2012 deri më 31.12.2013 është kryer auditim nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas raportit përfundimtar të auditimit dhe rekomandimeve dërguar me shkresën nr. 1075/6, datë 31.03.2014 nga të cilat nuk janë zbatuar plotësisht 1 masë organizative, pika 8 është realizuar pjesërisht, pasi aktualisht pas reformës territoriale me përfshirjen në Bashkinë Shijak edhe të tre ish Komunave (Maminas, Xhazotaj dhe Gjepalaj) saktësimi i gjendjes juridike me ZVRPP, inventarizimi dhe regjistrimi i pasurive mbetet në proces dhe

me përparësi dhe 4 masa për shpërbllim dëmi duke mbetur pa arkëtuar nga 28 persona vlera **12,381,000 lekë**.

**Rekomandim:** Bashkia Shijak të marrë masa për zbatimin e rekomandimeve të pa realizuara të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së, me shkresën nr.1075/6, datë 31.03.2014 dhe të arkëtohet nga 28 personat përgjegjës vlera **12,381,000 lekë**, detyrë e pa zbatuar nga auditimi i mëparshëm.

#### Në vijimësi

**2. Gjetje nga auditimi:** Bashkia Shijak nuk ka një rregullore ku të përfshihen raportet punëdhënës-punëmarrës për tre Njësitë Administrative. Rregullorja brendshme e viti 2012 që është akoma në fuqi, nuk ka të përcaktuar misionin e kësaj njësie vendore. Kësaj rregulloreje i mungon përcaktimi i formës dhe mënyrës së komunikimit si asaj verbale ashtu dhe asaj shkresore si dhe me rrjet elektronik, metoda e llogaridhënies, procedura në lidhje me administrimin, komunikimin dhe ruajtjen e dokumentacionit, procedurat e sinjalizimit të gabimeve, mashtrimit dhe parregullsive, delegimit të detyrave, rregullave të hyrjes në bashki, masave të sigurisë etj.

**Rekomandim:** Për shkak të ndryshimeve thelbësore që kanë pësuar Nj.Q.V, do të jetë e nevojshme një mënyrë e re organizimit të strukturave drejtuese dhe ndarjes së përgjegjësive, për shkak të futjes së përgjegjshmërisë menaxheriale. Për implementimin e një sistemi modern të menaxhimit financiar dhe kontrollit gjatë vitit 2016 e në vazhdim, rekomandojmë përgatitjen dhe përpunimin urgjentisht të rregullores të brendshme, të procedurave si dhe udhëzimeve përfshirë përskrimet e punës etj.

#### Menjëherë

**3. Gjetje nga auditimi:** Për trajnimin e stafit në Bashkinë Shijak, praktika e burimeve njerëzore nuk ishte e tillë që të garantonte zhvillimin e kompetencave profesionale të stafit pasi në këtë sektor nuk kishte programe specifike trajnimi si brenda dhe jashtë vendit, nga institucione kombëtare apo ndërkombëtare.

**Rekomandim:** Për ti shërbyer zhvillimit të metejshëm të Burimeve Njerëzore, duhet të hartohen dhe zhvillohen urgjentisht kurrikulat e trajnimit të shoqëruara me propozimet për trajnime të përshtatshme, duke patur parasysh nevojat e njësisë dhe të punonjësve të saj.

#### Menjëherë

**4. Gjetje nga auditimi:** Bashkia Shijak nuk ka kodin/rregulloren e vet të etikës në përputhje me legjislacionin në fuqi por edhe me veprimtarinë specifike të tij si dhe nuk kishte në plan të hartonte një të tillë. Në rregullore ishin përfshirë element të rregullave të etikës e të konfliktit të interes por në Bashkinë Shijak nuk ishin përcaktuar procedura për të raportuar shkeljet e legjislacionit mbi etikën dhe marrjen e masave për shkeljet e raportuara.

**Rekomandim:** Kuadri i sjelljes së menaxherëve dhe stafit duhet të përcaktohet nga titullari në një Kod të brendshëm Etike, ose në një Kod Sjelljeje, ndërsa përgjegjësia e menaxherëve qëndron në vendosjen dhe komunikimin e vlerave të etikës, përgjegjësia e gjithsecilit qëndron në demonstrimin e integritetit.

#### Menjëherë

**5. Gjetje nga auditimi:** Në fushën e menaxhimit të riskut procesi ende nuk kishte filluar, pasi akoma nuk kishte nisur procesi i analizës së riskut dhe nuk ishte hartuar regjistri i riskut. Gjithashtu për këtë institucion nuk kishte procedura të shkruara për menaxhimin e riskut, identifikimin, analizimin dhe kontrollin e risqeve të cilat mund të venë në rrezik arritjen e objektivave të Bashkisë. Në Bashkinë Shijak për periudhën e audituar nuk

ekzistonin procedura ku nëpunësit autorizues, gjatë ushtrimit të përgjegjësive të tyre, të kishin deleguar disa nga të drejtat dhe detyrat e tyre, tek punonjësit e nivelit menaxherial në varësi direkte, procedura të cilat nuk rezultojnë të shprehura as në rregulloren e saj.

**Rekomandim:** Strukturat e menaxhimit duhet të jenë të ndërtuara për të bërë të mundur arritjen e objektivave të politikës në mënyrë eficiente, në përputhje me standardet specifike dhe me afatin kohor të përcaktuar. Këto struktura duhet të koordinojnë punën për vendosjen e procesit të identifikimit dhe analizës së riskut, që përfshin objektivat specifike të njësisë dhe monitorimin e performancës. Gjithashtu strukturat e menaxhimit duhet të ngrejnë Grupin e Menaxhimit Strategjik GMS dhe të përcaktojnë koordinatorin e riskut si dhe nga menaxherët duhet të merren masat e duhura paraprake për të pakësuar nivelin e riskut për punonjësit që janë përfshirë në detyra me natyrë delikate me qëllim kufizimin e ushtrimit të influencave të dëmshme dhe të pasojave të tyre negative.

#### Në vijimësi

**6. Gjetje nga auditimi:** Nuk ka të miratuar një plan afatmesëm për rishikimin e sistemeve të brendshme të kontrollit të të gjithë niveleve të njësisë publike dhe përgatitjen e gjurmëve të auditimit për procedurat specifike të institucionit bazuar në kërkesat e Kreut III të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010. Në Bashkinë Shijak mungonte një komunikim efektiv, si vertikal, ashtu edhe horizontal në të gjitha nivelet e hierarkisë së njësisë. Ngritja dhe zhvillimi i një sistemi të përshtatshëm të informacionit për menaxhimin e njësisë ka si qëllim shpërndarjen e udhëzimeve dhe urdhrave të qartë dhe të saktë për rolet e çdo punonjësi të përfshirë në menaxhimin financiar dhe kontrollin.

**Rekomandim:** Përgjegjësi e Titullarit është miratimi dhe vënia në funksionim e sistemeve të informacionit dhe komunikimit, duke bërë të mundur që çdo punonjës të marrë përsipër përgjegjësitë përkatëse. Gjithashtu titullari duhet të ngrejë një sistem për dokumentimin dhe qarkullimin e dokumenteve, që përmbajnë rregullat për përgatitjen, formatimin, lëvizjen, përdorimin dhe arkivimin e dokumenteve, dokumentimin e të gjitha këtyre veprimtarive, proceseve dhe transaksioneve, me qëllim që të sigurohet gjurma e duhur e auditimit për vijueshmërinë dhe monitorimin, ngritja e një sistemi deklarimi efikas dhe të përpiktë, duke përfshirë format e deklaratave për rastet e zbulimit të gabimeve, të parregullsive, të abuzimit, të mashtrimit ose të përvetësimit, janë nevojë imediate për Bashkinë Shijak.

#### Në vijimësi

**7. Gjetje nga auditimi:** Kryetari i Bashkisë Shijak nuk kishte hartuar kalendarin e përgatitjes të PBA-së, nuk kishte miratuar tavanet përgatitore të shpenzimeve të PBA për çdo program. Gjithashtu nga Bashkia Shijak, projekt-buxheti përfundimtar është dorëzuar për miratim në Këshillin Bashkiak jashtë afateve të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor".

**Rekomandim:** Titullari i Bashkisë Shijak duhet të paraqesë pranë Këshillit të Bashkisë për miratim dokumentin e PBA-së 2015-2017 dhe brenda Qershorit çdo njësi e qeverisjes vendore duhet të dërgojë në MF, me shkrim dhe në rrugë elektronike, parashikimin e të ardhurave për periudhën afatmesme dhe parashikimin e shpërndarjes së burimeve financiare për periudhën afatmesme, të shoqëruar me një relacion për mënyrën e llogaritjes së PBA-së.

-Kryetari i Bashkisë Shijak, brenda muajit Nëntor të vitit buxhetor duhet të paraqesë për miratim projektbuxhetin në Këshillin Bashkiak dhe ky i fundit brenda datës 31 Dhjetor,

miraton buxhetin vendor në bazë të vlerësimit të ardhurave dhe të transfertave të pakushtëzuara të përcaktuara në ligjin e buxhetit vendor.

#### Në vijimësi

**8. Gjetje nga auditimi:** Gjatë auditimit të listëpagesave për vitet 2014-2015, rezultoi se 4 punonjës me detyrë roje dy në administratën e Bashkisë Shijak, një roje në çerdhe dhe një roje në Klubin Sportiv, janë paguar edhe për ditët e diela si orë suplementare, për të cilat nuk kishte miratim në formë urdhri nga titullari. Gjithashtu në kontratën e lidhur midis punëdhënësit dhe punëmarrësit nuk ishte parashikuar dhe ligjëruar orari i punës i rojeve mbi 40 orë në javë, as punësimi për ditët e shtuna apo të diela si dhe nuk ishte parashikuar në kontratat e punës një plan-shpërndarje e orëve të punës (grafiku për turnet e II apo të III) për të ruajtur dhe mbrojtur institucionet e sipërcituara.

**Rekomandim:** Shpërndarja e orëve të punës së rojeve duhet bërë e studjuar, me qëllim përdorimin me efektivitet të fondeve të Bashkisë Shijak duke kursyer 23.408 lekë/muaj si dhe duke krijuar mundësinë e punësimit me këto fonde edhe të një punonjësi tjetër.

#### Në vijimësi

**9. Gjetje nga auditimi:** Ndërtesat e tregut Fruta Perime Xhafzotaj në vlerën 23,790,000 lekë gjithsej nuk janë regjistruar në kontabilitet, pasi sipas marrëveshjes datë 17.02.2004 midis Ministrisë Bujqësisë dhe Ushqimit, Projektit FAO dhe Komunës Xhafzotaj e Bashkisë Shijak, kjo e fundit tashmë ka fituar pronësinë në masën 29,40% të vlerës së investimit ose në vlerën 6,994,260 lekë ndërsa në masën 70,60% të vlerës së investimit ose në vlerën 16,795,740 lekë për të cilën aktualisht pronësia është e Ministrisë Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 7661, datë 19.01.1993, ndryshuar me ligjin nr 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

**Rekomandim:** Bashkia Shijak të marrë të gjitha masat për ruajtjen dhe administrimin e objektit të tregut Fruta-Perime Xhafzotaj, të kërkojë nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregëtisë dhe Sipërmarrjes kalimin kapital të pronësisë së tij në favor të Bashkisë Shijak dhe të programojë mirë menaxhimin e tij.

#### Menjëherë

**10. Gjetje nga auditimi:** Objektet e ndërtesave të Bashkisë Shijak dhe të tre Njësive Administrative në vartësi të saj, nuk janë regjistruar në ZVRPP, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 8744, datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore” të ndryshuar, VKM nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pasurisë së paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore” dhe UKM nr. 3, datë 18.07.2002 dalë në zbatim të tij.

**Rekomandim:** Bashkia Shijak të marrë masat për plotësimin e dokumentacionit tekniko ligjor dhe regjistrimin në ZVRPP Durrës të trojeve dhe ndërtesave të Bashkisë Shijak dhe të tre Njësive Administrative në vartësi të saj.

#### Në vijimësi

**11 - Gjetje nga auditimi:** Bashkia Shijak nuk ka të ngritur apo strukturuar Drejtorinë apo Sektorin e Menaxhimit të Pronave dhe Strehimit dhe nuk ka dërguar për regjistrimin në ZVRPP Durrës të gjitha pasuritë në pronësi apo përdorim, si dhe për pronat të cilat rezultojnë të zëna forcërisht, nuk janë marrë masat e nevojshme për lirimin e tyre nga zaptuesit dhe përdoruesit e paligjshëm, veprim në papajtueshmëri me pika 26 e 27, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”

**Rekomandim:** Bashkia Shijak, të marrë masat dhe në miratimin e strukturës dhe ogranikës të NJQV-së të organizojë Drejtorinë apo Sektorin e Menaxhimit të Pronave dhe Strehimit, si dhe të marrë masa dhe të ndjek të gjitha procedurën ligjore për regjistrimin e pasurive të kaluara në pronësi, të mbaj dhe përditësoj regjistrin kontabël të aktiveve në pronësi apo administrim, si dhe për ato pasuri të cilat rezultojnë të zëna forcërisht të marrë masat për lirim dhe vënien në funksion të tyre.

**Menjëherë**

**12 - Gjetje nga auditimi:** Bashkia Shijak dhe tre Njësitë Administrative në Varësi, nuk kanë bërë një përditësim të pasurive në pronësi apo përdorim, sipas listëinventareve respektive të miratuara me VKM. Mospërditësimi i tyre ka sjellë për pasojë që për një pjesë të pasurive si objekte, toka bujqësore, toka pyjore e kullosore, kanale vaditëse, stacione pompimi, etj. të mos ketë dijeni për vendodhjen e tyre, gjendjen fizike, nivelin e amortizimit dhe nëse ka posedues të paligjshëm apo jo.

**Rekomandim:** Bashkia Shijak, pas miratimit të Drejtorisë apo Sektorit të Menaxhimit të Pronave dhe Strehimit, të marrë masat dhe organizojë punën për përditësimin e të gjitha pronave të bashkisë, në pronësi apo përdorim, dhe sipas rastit të vlerësoj mundësinë e vënies së tyre në përdorim, me qëllim mirëmbajtjen dhe krijimin e të ardhurave.

**Menjëherë**

**13 - Gjetje nga auditimi:** Bashkia Shijak, sipas VKM nr. 839, datë 22.07.2009, listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore me nr. rendor 51, pasuria 1966 “ndërtesë”, i ka kaluar në pronësi ish-Poligon Ndërtimi, ndodhur në Rrugën “Mihal Mihali”, Bashkia Shijak, me sipërfaqe ndërtimi 127,5 m<sup>2</sup>. Sipas të dhënave në fletën e inventarit, prona rezulton e “zënë nga qytetarët”. Po ashtu nga verifikimi i kryer nga punonjësit e Bashkisë Shijak më datë 25.04.2016, sipas kërkesës të grupit të auditimit të KLSH, është konstatuar se prona vijon të jetë në përdorim nga shoqëria “██████████”, me administrator N.J.

**Rekomandim:** Bashkia Shijak, referuar në kontratën e shitjes datë 05.11.1993 ndërmjet përfaqësuesit të Ndërmarrjes Komunale Banesa dhe Blerësit N.J, për objektin “Repart Marangoz+Poligon”, *ti kërkoj zyrtarisht qytetarit të paraqesë pranë Bashkisë Shijak dokumentin e fitimit pronës dhe planin e rilevimit të objektit, dhe me paraqitjen e tyre, të bëhet azhurnimi i listës së inventarit të pronave të Bashkisë Shijak, duke përditësuar në listë pronësinë mbi objektin, sipas procedurave ligjore.*

**Menjëherë**

**14 - Gjetje nga auditimi:** Bashkisë Shijak, i ka kaluar në pronësi pjesë e objektit të emëruar “Tregu fruta perime Xhafzotaj”, objekti i cili rezulton i pa vënë në funksion të qëllimit për të cilin është realizuar, që nga data e përfundimit të tij e deri më sot. Nga auditimi u konstatua se territori i një pjesë të tij, figuronte i zaptuar nga subjekti “██████████”, me administrator P.GJ. pasi ky subjekti kishte instaluar në të një sërë pajisjes industriale, por pa disponuar asnjë kërkesë për dhënien në përdorim të territorit dhe asnjë aktëmarrëveshje apo kontratë për dhënien me qira të pronës.

**Rekomandim:** Bashkia Shijak të marrë të gjitha masat për krijimin e marrëdhënies së bashkëpunimit dhe përcaktimin e efekteve financiare me subjektin ██████████ i cili rezulton se ka vendosur disa instalime në territorin e objekti, duke marrë në përdorim pa kontratë një sipërfaqe të tij, ose lirim e territorit nga poseduesi i pa autorizuar.

**Menjëherë**

**15 - Gjetje nga auditimi:** Bashkia Shijak, sipas VKM nr. 839, datë 22.07.2009, listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore me nr. rendor 50, pasuria 1975 “truall dhe

ndërtesë”, i ka kaluar në pronësi ish-Thertore, ndodhur në Rrugën “Mihal Mihali”, Bashkia Shijak, me sipërfaqe trualli prej 669 m<sup>2</sup> dhe me sipërfaqe ndërtimi 344 m<sup>2</sup>. Sipas të dhënave në fletën e inventarit, prona rezulton e “zënë nga qytetarët”. Po ashtu nga verifikimi i kryer nga punonjësit e Bashkisë Shijak më datë 25.04.2016, është konstatuar se prona vijon të jetë e zaptuar dhe në përdorim të paligjshëm, nga qytetarë të cilët aktualisht e përdorin për qëllime banimi. Lejimi i qytetarëve të përdorin lirshëm dhe pa asnjë pengesë, pronën e bashkisë, si dhe mos mbajtja e asnjë procesverbali konstatimi e pengimi apo masa për lirim e sendit, i ka mundësuar qytetarëve përdorimin e pronës në mënyrë të paligjshme dhe pa kundërshtim, në kundërshtim me VKM nr. 529, datë 08.6.2011 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfitëozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, ndryshuar me VKM nr. 54, datë 05.02.2014 dhe VKM nr. 735, datë 05.11.2014, VKM nr. 445, datë 20.05.2015, VKM nr. 992, datë 09.12.2015 dhe VKM nr. 299, datë 20.04.2016. Mos aplikimi i VKM-së *ka sjellë për pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e njësisë të qeverisjes vendore në vlerën prej 344 m<sup>2</sup>(ndërtesë) x 150 lekë/m<sup>2</sup>/muaj x 24 muaj =1,238,400 lekë.*

**Rekomandim:** Bashkia Shijak, të marrë masat për krijimin e marrëdhënies së bashkëpunimit dhe përcaktimin e efekteve financiare me personat të cilët kanë zaptuar objektin duke e marrë atë në përdorim pa kontratë, ose në rast të mosgjetjes së kompromisit apo kundërshtimit të veprohet me largimin nga objekti të poseduesve të pa autorizuar.

#### Menjëherë

**16. Gjetje nga auditimi:** Me urdhër shpenzimin nr. 378, datë 11.12.2015 në vlerën **800,000 lekë** është paguar subjekti “Në krahët e shpresës”, në zbatim të Vendimit të Këshillit të Bashkisë nr.19, datë 24.11.2015 për sponsorizim aktiviteti “Miss dhe Misster Shijaku 2015”, veprim në kundërshtim kërkesat e ligjit nr.7892, datë 21.12.1994 “Për sponsorizimin”.

**Rekomandim:** Bashkia Shijak në asnjë rast të mos programojë dhe të mos kryejë shpenzime për sponsorizime, pasi veprime të tilla nuk kanë mbështetje ligjore.

#### Në vijimësi

**17. Gjetje nga auditimi:** Në kërkesat për kualifikim të paraqitura në formatin elektronik, nga Njësia e Prokurimit, në disa raste, nuk është kërkuar, që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në tender të paraqesin:

-Vërtetim për shlyerjen e taksave e tarifave vendore në njësitë vendore ku kryejnë veprimtarinë.

-Numrin e nevojshëm të punonjësve, të dokumentuar nga organet tatimore me listëpagesat e sigurimeve shoqërore.

-Makineritë e pajisjet e nevojshme për realizimin në kohë të prokurimit.

-Bilancet dhe pasqyrat financiare për 3 vitet e mëparshme.

-Specifikimet teknike janë të përgjithshme.

-Liçensë profesionale për tregtimin e karburantit;

-Certifikatë cilësie për karburantin diezel që do të furnizojë.

**Rekomandim:** Nga Njësia e Prokurimit në çdo rast në dokumentet e tenderit duhet të kërkohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në tender të plotësojnë kërkesat për kualifikim sipas kërkesave ligjore.

#### Në vijimësi

**18. Gjetje nga auditimi:** Në dosjen e tenderit të zhvilluar nga ish Komuna Gjepalaj nuk ka asnjë dokument që të tregojë dhe argumentojë nevojat për karburant, çmimin e marrë për bazë dhe përcaktimin e fondit limit, specifikimet teknike dhe karakteristikat fiziko-kimike të karburantit dhe sasinë e karburantit të nevojshëm. Për sa më lart mban përgjegjësi Autoriteti Kontraktor dhe Njësia e Prokurimit, pasi ka vepruar në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” Kreun II pika 2 germa “c” e “ç”.

**Rekomandim:** Për një përdorim me efikasitet të fondeve publike të argumentohet domosdoshmëria e kryerjes së prokurimit me përcaktimin me përgjegjësi dhe nga persona kompetentë të sasive që do të prokurohen, me leverdinë ekonomike dhe volumet efektive të punëve që do të kryhen dhe të përcaktohen hollësisht specifikimet teknike, në zbatim të nenit 59 kreu VII “Zyrtarët e prokurimit dhe zhvillimi i procedurave”, miratuar me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

**Në vijimësi**

**19. Gjetje nga auditimi:** Gjatë auditimit të dokumenteve të bankës, u konstatuan në mjaft raste të kryerje së prokurimit të fondeve publike disa mangësi në drejtim të moszbatimit të urdhrit të Ministrisë së Financave nr. 33, datë 11.7.2013 “Për gjurmët standarde të auditit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë”, i hartuar në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM nr. 1, datë 10.1.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, nenin 43 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe nenet 15 e 22 të ligjit 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar e kontrollin” e konkretisht:

- Mungonte kërkesa e argumentuar nga sektorët e interesuar për kryerjen e shpenzimit brenda limitit që përcakton ligji të blerjet me vlera të vogla;
- Nuk ishin përcaktuar sipas rastit specifikimet teknike të shërbimit, apo mallit që do të blihej;
- Nuk evidentohet ngritja e grupit për testimin e tregut dhe as çmimet e marra për bazë në llogaritjen e fondit limit;
- Në disa raste në urdhër prokurimet nuk është argumentuar fondi limit.

**Rekomandim:** Në zbatimin e procedurës së prokurimit me vlera të vogla të përpilohet kërkesa nga sektori i interesuar duke argumentuar domosdoshmërinë, të ngrihet grupi për llogaritjen e fondit limit dhe të studiohet tregu, sipas përcaktimeve të gjurmëve standarde të zhvillimit të procedurës.

**Në vijimësi**

**20. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i të dhënave të Zyrës së Taksave e Tarifave Vendore konstatohet se deri në datën 31.12.2015 rezultoi se për mos pagesën e detyrimeve tatimore janë debitorë (subjektet e biznesit të vogël, biznesit të madh dhe taksat e tarifave familjare), **në vlerën prej 68,729,530 lekë** gjithsej.

Në vlerën e mësipërme për periudhën objekt auditimi, përfshihen debitorët e biznesit të vogël për taksat dhe tarifave vendore **në shumën 1,018,840 lekë**, ku përfshihet detyrimi i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, debitorët e biznesit të madh për detyrimet e taksave e tarifave vendore në vlerën **1,600,690 lekë** dhe detyrimet e subjekteve të pa regjistruara **në shumën 217,000 lekë**. Po kështu vlerën prej **65,893 mijë lekë**, e cila përfaqëson debitorët familjarë për shlyerjen e taksave e tarifave vendore, nga e cila për vitin 2013 në vlerën 21,625 mijë lekë, për vitin 2014 në vlerën 22,918 mijë lekë dhe për vitin 2015 në vlerën 21,350 mijë lekë.

**Rekomandim:** Nga ana e Sektorit të Taksave e Tarifave Vendore të Bashkisë Shijak, të merren masa për arkëtimin e detyrimeve debitore të pa arkëtuara në vlerën **2,836,530 lekë për sektorin e biznesit** dhe të vlerës **65,893 mijë lekë për popullatën.**

**Në vijimësi**

**21. Gjetje nga auditimi:** Nuk mbahet rregjistër i veçantë për vërtetimet e ndryshme, që lëshohen nga titullari për shërbimet që kryhen ndaj komunitetit dhe për licensat dhe certifikatat e transportit që lëshohen nga zyra e transportit, për therjet e bagëtive që lëshohen nga shërbimi veteriner, për tu krahasuar me arkëtimet në fakt nga çdo qytetar për shërbimin e ofruar, shërbime të cilat kryhen pa pagesë. Ky veprim bie ndesh me kërkesat e UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “ *Për menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik*”.

**Rekomandim:** Bashkia Shijak dhe Sektori i Taksave e Tarifave Vendore të Bashkisë, të marrë masa për caktimin e tarifave vendore të dokumenteve zyrtare që lëshohen nga institucioni dhe pas miratimit në Këshillin Bashkiak të administrojë në regjistër të veçantë gjithë dokumentacionin e lëshuar dhe tarifat e arkëtuara.

**Menjëherë**

**22. Gjetje nga auditimi:** Për vitin 2014 komisioni i vlerësimit të materialeve për jashtë përdorimit i përbërë nga gjashtë punonjës **Sh D, L D, J G, E Sh** dhe **L K** kanë mbajtur 28 procesverbalet datë 28.12.2014 mbi vlerësimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të vlerave materiale të cilat janë mbajtur me mangësi. Në këto procesverbale nuk ka të përcaktuar vitet në përdorim të inventarit, amortizimin e llogaritur në vite, vlerën e mbetur, vlerësimi i kostos përfshirë dhe shitjen për skrap të materialeve që mund të përfitohen duke i ndarë ato nga materialet që do të asgjësohen.

Nxjerrja jashtë përdorimit dhe asgjësimi i vlerave materiale për vitin **2014**, si më sipër dhe sistemimi në kontabilitet, janë veprime në kundërshtim me kërkesat e nenit 6, kreu II neni 7 “*Mbajtja e kontabilitetit dhe inventarizimi i aktiveve*” të ligjit nr.9228, datë 29.04.2004 “*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*”, neni 12 pika 3, neni 16 pika 2, neni 23 pika 5 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin*” dhe, kreu III pika 35 germa c “*Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve*”, kreu IV pika 109, neni 73 deri në nenin 106, të UMF nr.30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”.

**Rekomandim:** Drejtoria e Financës nëpërmes komisionit të vlerësimit të materialeve për jashtë përdorimit dhe magazinierit të Bashkisë Shijak, në inventarizimet e vlerave materiale, të përcaktojë sasinë dhe vlerën materialeve skrap që mund të përfitohen duke i ndarë ato nga materialet që do të asgjësohen.

**Në vijimësi**

**23. Gjetje nga auditimi:** Me urdhër shpenzimin nr. 193, datë 13.11.2014 në vlerën 400,000 lekë është paguar P.D. ish punonjës i Bashkisë, për largim të pa drejtë nga puna me shkresën nr.509 datë 30.06.2010, në zbatim të Vendimit të Gjykatës së Apelit Durrës nr.417, datë 27.05.2013 i cili përbën impakt negativ në rritjen e shpenzimeve, shkaktuar ndaj buxhetit të Bashkisë Shijak.

Me urdhër shpenzimin nr. 194, datë 13.11.2014 në vlerën 550,000 lekë është paguar A. Xh. ish punonjës i Bashkisë, për largim të pa drejtë nga puna me shkresën nr.509 datë 30.06.2010, në zbatim të Vendimit të Gjykatës së Apelit Durrës nr.854, datë 03.12.2012 i cili përbën impakt negativ në rritjen e shpenzimeve, shkaktuar ndaj buxhetit të Bashkisë Shijak.



Me urdhër shpenzimin nr. 196, datë 18.11.2014 në vlerën 4,700,000 lekë është paguar S H Përmbaues, në zbatim të Vendimit të Gjykatës së rrethit Gjyqësor Durrës nr.1118, datë 16.05.2006 dhe Vendimit të Gjykatës së Apelit Durrës nr.215, datë 25.02.2014 për llogari të subjektit "██████████".

Me urdhër shpenzimin nr. 352, datë 24.11.2015 në vlerën 403,228 lekë është paguar S H Përmbaues, në zbatim të Vendimit të Gjykatës së rrethit Gjyqësor Durrës nr.1118, datë 16.05.2006 dhe Vendimit të Gjykatës së Apelit Durrës nr.215, datë 25.02.2014 për llogari të subjektit "██████████".

Veprimet e largimit të pa motivuar nga puna të punonjësve dhe ndërprerjes së njëanshme dhe të pa drejtë të kontratës, si më sipër, kanë shkaktuar impakt negativ në shpenzimet e planifikuara për paga të punonjësve, të cilat bien në kundërshtim me nenet 143,144,145,146,153,155 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës" i ndryshuar dhe nenet 126 deri në 306 -310 të Kodit të Procedurës Civile.

**Rekomandim:** Për pagesat e kryera nëpërmes Zyrës Përmbauese për detyrimet që rrjedhin nga vendimet gjyqësore të formës së prerë, për largime të pamotivuara nga puna dhe ndërprerjes së njëanshme dhe të pa drejtë të kontratës para vitit 2013 në vlerën **6,053,228 lekë** gjithsej, Këshilli i Bashkisë Shijak të analizojë veprimet e kryera dhe nxjerrë përgjegjësinë.

**Brenda datës 31.07.2016**

**24. Gjetje nga auditimi:** Për vitin 2014 në shtatë raste në vlerën **20,792,70 lekë** është paguar subjekti "██████████" Dega Shijak për detyrimi për kamatëvonesa të likuidimit të shpenzimeve telefonike si më poshtë:

-Me urdhër shpenzimin nr. 31 datë 04.03.2014 në vlerën 112,944 lekë është paguar subjekti "██████████" Dega Shijak për shpenzimet telefonike për muajt Tetor, Nëntor, Dhjetor 2013 dhe Janar 2014 . Në vlerën e mësipërme është likuiduar edhe detyrimi për kamatëvonesa në vlerën 7,442,70 lekë gjithsej e detajuar sipas muajve Tetor 2013 në vlerën 1,787,40 lekë, Nëntor 2013 në vlerën 1,817,70 lekë, Dhjetor 2013 në vlerën 2,018,55 lekë dhe Janar 2014 në vlerën 1,819,05 lekë.

-Me urdhër shpenzimin nr. 75 datë 13.05.2014 në vlerën 53,066 lekë është paguar subjekti "██████████" Dega Shijak për shpenzimet telefonike për muajt Shkurt dhe Mars 2014. Në vlerën e mësipërme është likuiduar edhe detyrimi për kamatëvonesa në vlerën 3,017,20 lekë gjithsej e detajuar sipas muajve Shkurt 2014 në vlerën 2,090,85 lekë dhe Mars 2014 në vlerën 926,35 lekë.

-Me urdhër shpenzimin nr. 107 datë 18.06.2014 në vlerën 59,931 lekë është paguar subjekti "██████████" Dega Shijak për shpenzimet telefonike për muajt Prill dhe Maj 2014. Në vlerën e mësipërme është likuiduar edhe detyrimi për kamatëvonesa në vlerën 3,753,30 lekë gjithsej e detajuar sipas muajve Prill 2014 në vlerën 1,835,25 lekë dhe Maj 2014 në vlerën 1,918,05 lekë.

-Me urdhër shpenzimin nr. 177 datë 26.08.2014 në vlerën 49,453 lekë është paguar "██████████" Dega Shijak për shpenzimet telefonike për muajt Qershor dhe Korrik 2014. Në vlerën e mësipërme është likuiduar kamatëvonesa në vlerën 2,021,70 lekë.

- Me urdhër shpenzimin nr. 153 datë 09.10.2014 në vlerën 21,789 lekë është paguar "██████████" Dega Shijak për shpenzimet telefonike për muajt Gusht 2014. Në vlerën e mësipërme është likuiduar edhe kamatëvonesa në vlerën 1,778,70 lekë.

- Me urdhër shpenzimin nr. 213 datë 09.12.2014 në vlerën 18,280 lekë është paguar subjekti "██████████" Dega Shijak për shpenzimet telefonike për muajt Tetor 2014. Në vlerën e mësipërme është likuiduar edhe kamatëvonesa në vlerën 1,778,70 lekë.

-Me urdhër shpenzimin nr. 239 datë 23.12.2014 në vlerën 22,675 lekë është paguar subjekti "██████████" Dega Shijak për shpenzimet telefonike për muajt Nëntor 2014. Në vlerën e mësipërme është likuiduar edhe kamatëvonesa në vlerën 1,000,40 lekë.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me me nenin 35 germa a, nenin 38 të UKM nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*".

**25. Gjetje nga auditimi:** Për vitin 2015 në katër raste në vlerën **7,335,60 lekë** është paguar subjekti "A" Dega Shijak për detyrimi për kamatëvonesa të likuidimit të shpenzimeve telefonike si më poshtë:

-Me urdhër shpenzimin nr. 342 datë 17.03.2015 në vlerën 77,644 lekë është paguar subjekti "██████████" Dega Shijak për shpenzimet telefonike për muajt Janar dhe Shkurt 2014. Në vlerën e mësipërme është likuiduar edhe detyrimi për kamatëvonesa në vlerën **2,784,30 lekë** gjithsej e detajuar sipas muajve Tetor 2014 në vlerën 864 lekë dhe Dhjetor 2014 në vlerën 1920,30 lekë.

-Me urdhër shpenzimin nr. 68 datë 15.04.2015 në vlerën 25,703 lekë është paguar subjekti "██████████" Dega Shijak për shpenzimet telefonike për muajin Mars 2015. Në vlerën e mësipërme është likuiduar edhe kamatëvonesa në vlerën **1,838,70 lekë**.

-Me urdhër shpenzimin nr. 254 datë 23.09.2015 në vlerën 46,858 lekë është paguar subjekti "██████████" Dega Shijak për shpenzimet telefonike për muajit Qershor- Korrik 2015. Në vlerën e mësipërme është likuiduar edhe kamatëvonesa në vlerën **1,796,30 lekë**.

-Me urdhër shpenzimin nr. 345 datë 20.11.2015 në vlerën 27,397 lekë është paguar subjekti "██████████" Dega Shijak për shpenzimet telefonike për muajit Shtator- Tetor 2015. Në vlerën e mësipërme është likuiduar edhe kamatëvonesa në vlerën **916,30 lekë**. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me me nenin 35 germa a, nenin 38 të UKM nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*".

**Rekomandim:** Për pagesat e kryera për kamatëvonesa për llogari të subjektit "██████████" Dega Shijak në vlerën **28,128,30 lekë gjithsej**, nga të cilat në shtatë raste në vlerën 20,792,70 lekë për vitin 2014 dhe në katër raste në vlerën 7,335,60 lekë për vitin 2015, Këshilli i Bashkisë Shijak të analizojë veprimet e kryera dhe nxjerrë përgjegjësinë.

**Brenda datës 31.07.2016**

**26. Gjetje nga auditimi:** Për furnizimet me ushqime për kopsht e çerdhe dhe mallra të ndryshme në faturat e furnitorit dhe fletëhyrjet e magazinës mungon kartela limit e furnizimeve ditore të kryera.

-Nuk është ngritur komision për pritjen dhe kolaudimin e ushqimeve, megjithëse janë dokumentuar me fletë hyrje në magazinë, sikurse e kërkon UKM nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*", kapitulli "*Marrja në dorëzim e aktiveve të furnizuara*" pika 42 e 43 veprim i cili bie në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 1, dt. 10.01.2007, "*Për rregullat e prokurimit publik*" kreu VIII, pika 2/b : "*Për t'u siguruar nëse cilësia .... e mallrave është e njëjtë me cilësinë e premtuar në ofertë, autoriteti kontraktor duhet të monitorojë zbatimin e kontratës ose lëvrimet,.. Autoriteti kontraktor, ...mban procesverbal, me shkrim. Në përfundim të kontratës, autoriteti kontraktor përgatit një raport përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës*" dhe të UKM nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*" kapitulli "*Veprimet që kryejnë strukturat e Nëpunësit Zbatues*" pika 54 që

shprehet: “Për hyrjet që bëhen nga blerjet me fondet buxhetore, strukturat përgjegjëse për financat duhet të kontrollojnë në se fletëhyrja ka të bashkëlidhur dokumentacionin justifikues përkatës që vërteton marrjen në dorëzim të aktiveve, sipas kushteve të kontratës, si procesverbali i firmosur nga komisioni, fatura e furnitorit, situacione të shpenzimeve për investimet, fletë hyrje origjinale, procesverbal i marrjes në dorëzim të mallit, etj”.

**Rekomandim:** Titullari i Bashkisë, për të gjitha mallrat e furnizuara dhe sidomos ushqimet, sipas kontratave të sipërmarrjes të ngrejë grupin e kolaudimit dhe të marrjes në dorëzim të tyre me specialistë të fushës, konformë dispozitave ligjore.

**Menjëherë**

**27. Gjetje nga auditimi:** Inspektorati i Mbrojtjes dhe Kontrollit të Territorit, Bashkia Shijak gjatë vitit 2014, gjithsej për 4 subjekte, ka vendosur gjoba në vlerën totale prej 500,000 lekë, por pa ndjekur rrugët ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin e ndërtimit” i ndryshuar, VKM-së nr. 862, datë 05.12.2007 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga INUK dhe INUV” i ndryshuar.

Në 5 raste është mbajtur vetëm procesverbal konstatimi për qytetarin **Sh.Zh, L.L, N.C, E.K, dhe S.B**, pa u vendosur asnjë masë ndëshkuese, veprime në kundërshtim me pikën 8 “Kryerje punimesh pa leje” të nenit 82 të ligjit 10119 datë 23.04.2009 “Për Planifikimin e Territorit” dhe nenit 5 gërma b të ligjit nr 9780 datë 16.07.2007 “Për inspektoratin e ndërtimit”, kur duhej të kishte gjobitur subjektet e mësipërme me vlerën minimale 100,000 x 5 subjekte = 500,000 lekë, vlerë kjo e pa arkëtuar e cila përbën një të ardhur të munguar me dëm për buxhetin e njësisë vendore.

Për periudhën objekt auditimi, gjatë ushtrimit të veprimtarisë dhe në përmbushje të detyrës funksionale të parashikuar në ligjin nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin e ndërtimit” i ndryshuar, VKM-së nr. 862, datë 05.12.2007 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga INUK dhe INUV” i ndryshuar, IMT Bashkia Shijak, ka marrë 8 vendime për prishje objektesh pa leje, vendime të cilat rezultojnë të pa ekzekutuar.

**Rekomandim:** Nga Bashkia Shijak dhe Inspektorati i Mbrojtjes dhe Kontrollit të Territorit të merren të gjitha masat për arkëtimin e gjobave në vlerën prej 500,000 lekë, të cilat përbëjnë të ardhura të munguara për buxhetin e NJQV, të vendosë gjobë po në masën prej 500,000 lekë për subjektet për të cilat është konstatuar ndërtimi pa leje, si dhe të marrë masat për ekzekutimin e 8 vendimeve për prishjen e ndërtimeve pa leje.

**Menjëherë**

## **B. MASA SHPËRBLIM DËMI**

*Mbështetur në ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” i ndryshuar, kreu IV, nenet 9-14, të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, pjesa VI, kreu I, nenet 105-109, nga ana e Bashkisë Shijak të nxirren aktet administrative, të kryhen kontabilizimet dhe të kërkohet shpërblimi i dëmit në vlerën 27,311,729 lekë gjithsej, si më poshtë:*

**1. Gjetje nga auditimi:** Objekti i kontratës datë 10.07.2007 me palë qiradhënëse Bashkinë Shijak, përfaqësuar nga ish-Kryetari Bashkisë A.A. (konceptuar nga ish-juristja T.K.) dhe palë qiramarrëse “XXXXXXXXXX” është dhënia me qira e një sipërfaqe trualli prej 4250 m<sup>2</sup>,

pjesë e ish-Ndërmarrja Ushqimore Shijak-Fabrika e Bukës, truall në pronësi të Bashkisë Shijak. Kontrata është për një periudhë të pa përcaktuar.

Kontrata e qirasë i referohet kontratës së privatizimit nga "██████████" të ish-Fabrika e Bukës, më datë 04.10.1994 dhe formularit të dhënies me qira të tokës, sipas të cilës  $0,56 \times 4250 = 2380$  USD. Lidhur me procedurat e zbatim të kontratës së qirasë, rezulton se nuk kanë gjetur zbatim plotësisht referencat ligjore të sipërcituara, pasi sipas VKM nr. 738, datë 08.09.2010, pika 10 "Pagesa e qirasë së truallit në përdorim, sipërfaqe e domosdoshme për subjektet, që e kanë paguar dhe që duhet të paguajnë rregullisht atë deri në datën 07.06.2010, për objektet e privatizuara, bëhet në zbatim të akteve ligjore e nënligjore, sipas periudhave përkatëse dhe kontratave të qirasë të lidhura për këtë qëllim, e cila është me një cmim vjetor sa  $1/10$  e vlerës së truallit", duke qenë se vlera e truallit sipas VKM-ve respektive është më e lartë se ajo e përcaktuar në kontratë, nuk kanë gjetur zbatim aktet ligjore në fuqi dhe konkretisht:

VKM nr. 1620, datë 26.11.2008 "Për miratimin e çmimeve të trojeve që ndodhen në të gjitha bashkitë dhe disa komuna", ka përcaktuar se vlera për zonën kadastrale nr.3369, Bashkia Shijak është 11600 lekë, pra  $11600 \text{ lekë/m}^2 \times 4250 \text{ m}^2 \times 0.1$  ( $1/10$  e vlerës së truallit) = 4,930,000 lekë, shumë e cila përbën të ardhura të munguar me pasojë dëm ekonomik për buxhetin. Në total  $4,930,000 \text{ lekë} \times 4 \text{ vjet}$  (2009 deri më 2012) = **19,720,000 lekë**. VKM nr. 187, datë 06.03.2013 "Për miratimin e vlerës së pronës për secilin qark", ka përcaktuar se vlera për zonën kadastrale nr.3369, Bashkia Shijak është 7679 lekë, pra  $7679 \text{ lekë/m}^2 \times 4250 \text{ m}^2 \times 0.1$  ( $1/10$  e vlerës së truallit) = **3,263,575 lekë**, shumë e cila përbën të ardhura të munguar me pasojë dëm ekonomik për buxhetin.

Për periudhën objekt auditimi, duhej aplikuar VKM nr. 514, datë 30.07.2014 "Për miratimin e vlerës së pronës për secilin qark", e cila ka përcaktuar se vlera për zonën kadastrale 3369, Bashkia Shijak është 3047 lekë/m<sup>2</sup>, pra  $3047 \text{ lekë/m}^2 \times 4250 \text{ m}^2 \times 0.1$  ( $1/10$  e vlerës së truallit) = 1,294,975 lekë, shumë e cila përbën të ardhura të munguar me pasojë dëm ekonomik për buxhetin. Në total  $1,294,975 \text{ lekë} \times 2 \text{ vjet}$  (2014 deri më 2015) = **2,589,950 lekë**.

**Shumave të sipër cituara, 25,573,525 lekë i zbritet dhe pagesa e kryer nga subjekti gjatë këtyre 7 viteve duke bërë që detyrimi total të shkojë në vlerën prej (25,573,525-952,000 lekë) 24,521,525 lekë** (Trajtuar në faqet 183-184 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**Rekomandim:** Drejtoria e Financës të kontabilizojë detyrimin për llogari të qiramarrësit "██████████" në vlerën **24,521,525 lekë**, që përbën vlerën e qirasë së truallit për 7 vite dhe të marrë masat për arkëtimin e detyrimit.

#### **Brenda vitit 2016**

**2. Gjetje nga auditimi:** Për vitin 2014-2015 janë urdhëruar nga Kryetarët e Bashkisë, I.B. për periudhën Janar 2014-Korrik 2015 dhe A.K. për periudhën Gusht 2015 -Janar 2016 dhe janë zbatuar nga drejtore e financës P.A, pagesat në shumën **1,186,767 lekë**, për këshilltarët që nuk kanë qenë pjesmarrës në mbledhjet e Këshillit Bashkiak, sipas përcaktimeve të bëra tabelat bashkëlidhur.

**Rekomandim:** Të kërkohet në rrugë ligjore (nxirret urdhri) për shpërblimin e dëmit, të kryhen kontabilizimet dhe bëhen **ndalesat në vlerën 1,186,767 lekë** nga të gjithë këshilltarët të cilët nuk kanë marrë pjesë në mbledhje, duke ndjekur të gjithë procedurat e nevojshme administrative dhe në të gjitha shkallët e gjykimit.

**Brenda datës 31.08.2016**

3. Gjetje nga auditimi: Në zbatimin e punimeve të kontraktuara me operatorin ekonomik “██████████” për shërbimin e pastrimit dhe gjelbërimit të Komunës Xhafzotaj u konstatuan punime të pa kryera dhe të përfituara padrejtësisht në vlerën 594,987 lekë, veprime në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr.8094, datë 21.03.1996 “Për largimin publik të mbeturinave” dhe në “Zona e mbetjeve 2”, faqe 18,19 dhe 20 të VKM nr.175, datë 19.01.2011 “Për miratimin e strategjisë kombëtare të menaxhimit të mbetjeve dhe të planit kombëtar të menaxhimit të mbetjeve” të cilat përbëjnë shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik dhe detyrim për arkëtim nga përfituesi.

**Rekomandim:** Drejtoria e Financës të kontabilizojë dhe të marrë masa për arkëtimin e detyrimit nga subjekti “██████████” në vlerën **594,987 lekë**.

**Brenda datës 31.07.2016**

5. Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dosjes së tenderit “Grumbullim i mbeturinave të fshatrave dhe mirëmbajtje e sipërfaqeve të gjelbëruara në Komunën Xhafzotaj” konstatohet se është vepruar në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 59 “Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës”.

Mbi bazën ligjore, përcaktuar në “Zona e mbetjeve 2”, faqe 18,19 dhe 20 të VKM nr.175, datë 19.01.2011 “Për miratimin e strategjisë kombëtare të menaxhimit të mbetjeve dhe të planit kombëtar të menaxhimit të mbetjeve” dhe sipas Gjendjes Civile të Komunës Xhafzotaj rezultojnë 18,294 banor gjithsej **duhej llogaritur** 18,294 banorë në sasinë 0,7 kg/frymë në ditë ose 12,806 kg në ditë x 365 ditë baras 4,674,117 kg në vit : 602 kg/m3 baras në sasinë prej 7,764m3 në vlerën 4,906,848 lekë.

- Në preventivin ofertues dhe fitues është paraqitur, situacionuar dhe likuiduar për llogari të operatorit ekonomik “██████████” sasia prej 8,900 m3 mbeturina në vlerën 5,607,000 lekë ndërkohë që duhej llogaritur sasia 7,764 m3 mbeturina dhe paguar vlera 4,891,320 lekë ose paguar më tepër sasia 1,136 m3 në vlerën **477,120 lekë**, e cila përbën shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik dhe detyrim për arkëtim nga përfituesi.

**Rekomandim:** Drejtoria e Financës të kontabilizojë dhe të marrë masa për arkëtimin e detyrimit nga subjekti “██████████” në vlerën **477,120 lekë**.

**Brenda datës 30.09.2016**

6. Gjetje nga auditimi: Me urdhër shpenzimin nr. 423 datë 30.12.2015 është paguar subjekti “██████████” për shpenzimet e mobilimit të zyrave të Bashkisë Shijak. Në preventiv dhe situacion janë përfshirë 13 artikuj pajisje inventar ekonomik në vlerën 649,000 lekë mbi të cilën është aplikuar TVSH në vlerën **129,800 lekë**, (Zëri An. 8 Tavolinë 1 x 30,000 lekë, An.9 Tavolinë mbledhje 1 x 40,000 lekë, An.9 blloqe sirtari 2 baras 9,000 lekë, An.12 Dollap MDF 1 x 25,000 lekë, An.13 Tavolinë zyre MDF 1 x 35,000 lekë, An.14 Komodina MDF 4 baras 72,000 lekë, An.15 Komodina melamini 4 baras 12,000 lekë, An.16 Tavolina MDF 1 x 20,000 lekë, An.17 Tavolina melamini 1 x 18,000 lekë, An.24 Karrike lëkure me krah 9 baras 54,000 lekë, An.25 Karrike lëkure pa krah 39 baras 234,000 lekë, An.26 Karrike me rrota për kompjuter 1 x 35,000 lekë dhe An.33 Televizor 42 copë 1 x 65,000 lekë), i cili bie në kundërshtim me kërkesat e VKM nr.704, datë 29.10.2014 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim” ndryshuar me VKM nr.888, datë 17.12.2014 dhe përbën shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik dhe detyrim për arkëtim nga përfituesi.

**Rekomandim:** Drejtoria e Financës të kontabilizojë dhe të marrë masa për arkëtimin e detyrimit nga subjekti “██████████” në vlerën **129,800 lekë**.

**Brenda datës 30.06.2016**

**7. Gjetje nga auditimi:** Në prokurimin “Blerje karburanti”, ish Komuna Gjepalaj, në dokumentacionin kualifikues të paraqitur në formatin elektronik u konstatua se dokumentacioni kualifikues i operatorëve ekonomikë kishte këto mangësi:

- Operatori ekonomik Shoqëria “██████████” sh.p.k është skualifikuar se “Përlllogaritja e vlerës absolute e marzhit është bërë për benzinë 10pp, ndërkohë që objekti i prokurimit është gazoil”, në një kohë që oferta ekonomike e paraqitur në formatin elektronik është ██████”.

Në këto kushte operatori ekonomik “██████████” sh.p.k duhej të ishte kualifikuar.

- Operatori ekonomik Shoqëria “██████████” sh.a. i shpallur fitues ka mangësi në dokumentacionin kualifikues pasi:

**a.** Nuk ka paraqitur licensë për tregtim të karburantit me pakicë.

**b.** Për plotësimin e kërkesës “Kapaciteti teknik” për deklarimin e furnizimeve të ngjashme, ka paraqitur kontratën e furnizimit të TEC-it Vlorë me 7,000 m<sup>3</sup> karburant, pra tregti me shumicë dhe nuk ka paraqitur dokument për veprimtari të tregtisë me pakicë.

Në këto kushte Operatori ekonomik Shoqëria “██████████” sh.a. duhej të ishte skualifikuar.

Nga auditimi i dokumenteve të tenderit rezulton se duhej të ishte shpallur fitues operatori ekonomik Shoqëria “██████████” sh.p.k., pasi oferta ekonomike është më e ulët, e konkretisht: Diferenca midis çmimeve të dy ofertave është 17.41 lekë/litër (152.41 – 135.53) dhe për sasinë e furnizuar prej 5,440 litra vlera e paguar tepër rezulton **94,710 lekë** pa TVSH.

**Rekomandim:** Vlera **94,710 lekë** pa TVSH, që përbën diferencën ndërmjet ofertës së operatorit ekonomik “██████████” sh.a., të shpallur fitues dhe ofertës së operatorit ekonomik Shoqërisë “██████████” sh.p.k., e cila duhej të ishte shpallur fituese, të zhdëmtohet nga anëtarët e KVO-së E.R, D.S. e L.S.

**Brenda datës 31.08.2016**

**8. Gjetje nga auditimi:** Me urdhër shpenzimin nr. 302, datë 28.10.2015 për llogari të subjektit “██████████” është kryer pagesë për blerje materiale dhe riparime në shkolla. Në preventivin e hartuar nga J.G. dhe situacionin e punimeve të likuiduara mbi vlerën e punimeve të ndërtimit është përfshirë zëri puntori e specializuar e pa argumentuar për 150 orë pune në vlerën **27,750 lekë**

Në dokumentacionin e pagesës, nuk është aplikuar sanksion për 16 ditë vonesa në dorëzimin e punimeve sipas përcaktimeve të bëra nenin 2 të kontratës bazuar në Kushtet e Përgjithshme të Kontratës neni 24.1 Likuidimi i dëmeve për dorëzimin e vonuar pika a e DST vlera e kontratës 650,000 lekë x 16 ditë vonesa x 4/000 lekë për ditë vonesë baras në vlerën **41,600 lekë**, pa TVSH, e cila përbën dëm ekonomik, shkaktuar ndaj buxhetit të Bashkisë Shijak dhe detyrim për arkëtim nga përfituesi.

**Rekomandim:** Drejtoria e Financës të kontabilizojë dhe të marrë masa për arkëtimin e detyrimit nga subjekti “██████████” në vlerën **69,350 lekë** gjithsej.

**Brenda datës 30.06.2016**

**9. Gjetje nga auditimi:** Me urdhër shpenzimin nr. 307, datë 29.10.2015 për llogari të subjektit “██████████” është kryer pagesë për arredimin e zyrave të Bashkisë, për të cilin nuk është aplikuar sanksion për 23 ditë vonesa në dorëzimin e punimeve sipas përcaktimeve të bëra nenin 2 të kontratës bazuar në Kushtet e Përgjithshme të Kontratës

neni 24.1 Likuidimi i dëmeve për dorëzimin e vonuar pika a e DST vlera e kontratës 687,000 lekë x 23 ditë vonesa x 4/000 lekë për ditë vonesë baras në vlerën **63,204 lekë**, pa TVSH, e cila përbën dëm ekonomik, shkaktuar ndaj buxhetit të Bashkisë Shijak dhe detyrim për arkëtim nga përfituesi.

**Rekomandim:** Drejtoria e Financës të kontabilizojë dhe të marrë masa për arkëtimin e detyrimit nga subjekti“ [REDAKTUAR]” në vlerën **63,204 lekë**.

**Brenda datës 30.06.2016**

**10. Gjetje nga auditimi:** Në zbatimin e punimeve të kontraktuara me operatorin ekonomik “[REDAKTUAR]” për shërbimin e pastrimit dhe gjelbërimit të qytetit Shijak u konstatuan punime të pa kryera dhe të përfituara padrejtësisht në vlerën 30,401 lekë, veprime në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr.8094, datë 21.03.1996 “Për largimin publik të mbeturinave” dhe në “Zona e mbetjeve 2”, faqe 18,19 dhe 20 të VKM nr.175, datë 19.01.2011 “Për miratimin e strategjisë kombëtare të menaxhimit të mbetjeve dhe të planit kombëtar të menaxhimit të mbetjeve” të cilat përbëjnë shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik dhe detyrim për arkëtim nga përfituesi.

**Rekomandim:** Drejtoria e Financës të kontabilizojë dhe të marrë masa për arkëtimin e detyrimit nga subjekti“ [REDAKTUAR]” në vlerën **30,401 lekë**.

**Brenda datës 30.06.2016**

**11. Gjetje nga auditimi:** Në dokumentacionin kualifikues në tenderi me objekt “Mobilim i zyrave të Bashkisë Shijak” të paraqitur në formatin elektronik u konstatua se nuk qëndrojnë mangësitë e evidentuara në dokumentacionin kualifikues të operatorit ekonomik konkurrent Shoqëria “[REDAKTUAR]” sh.p.k. dhe se nuk qëndrojnë arsyetimet e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për mangësi të paraqitura për kontrata për punë ngjashme me MEI, pasi kërkesat për punë të ngjashme plotësohen edhe dokumentet për punë të ngjashme të kryera me OST-në. Në këto kushte operatori ekonomik Shoqëria “[REDAKTUAR]” sh.p.k. duhej të ishte kualifikuar dhe të ishte shpallur fituese me ofertën ekonomike 1,718,293 lekë pa TVSH, pra **22,917 lekë** më të ulët se oferta e shpallur fituese, për të cilën duhet të përgjigjet Komisioni i Vlerësimit të Ofertave.

**Rekomandim:** Vlera **22,917 lekë pa TVSH**, që përbën diferencën ndërmjet ofertës së operatorit ekonomik “[REDAKTUAR]” sh.p.k., në shumën 2,089,542 lekë pa TVSH, të shpallur fituese dhe ofertës së operatorit ekonomik Shoqërisë “[REDAKTUAR]” sh.p.k. & Shoqërisë “[REDAKTUAR]” sh.p.k. në shumën 1,718,293 lekë pa TVSH, e cila duhej të ishte shpallur fituese, të zhdëmtohet nga anëtarët e KVO-së SH.D, P.A. e S.H.

**Brenda datës 30.06.2016**

**12. Gjetje nga auditimi:** Me urdhër shpenzimin nr. 232, datë 16.12.2014 për llogari të subjektit “[REDAKTUAR]” është kryer pagesë për “gërmim kanali dhe pastrim i lumit tek rruga Dushk”. Në situacionin e punimeve është likuiduar më tepër zëri 2 transport dhe me auto deri në 2 km në volumin 100 m3 dhe vlerë **17,000 lekë** ndërkohë që në zërin 1 gërmimi i dheut me eskavator është parashikuar me shkarkim në tokë. Veprimet e mësipërme përbëjnë shkelje të kërkesave të ligjit nr.8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, VKM nr. 47, datë 21.01.2013 “Për një shtesë në VKM nr. 45, datë 21.01.2009 “Për kryerjen e procedurave të prokurimit në mënyrë elektronike” i ndryshuar.

**Rekomandim:** Drejtoria e Financës të kontabilizojë dhe të marrë masa për arkëtimin e detyrimit nga subjekti“ [REDAKTUAR]” në vlerën **17,000 lekë**.

**Brenda datës 30.06.2016**

**13. Gjetje nga auditimi:** Me urdhër shpenzimin nr. 78, datë 23.04.2015 për llogari të subjektit “██████████” është kryer pagesë për blerje pajisje për Qendrën Multifunktionale, për të cilin nuk është aplikuar sanksion për 5 ditë vonesa në dorëzimin e materialeve sportive sipas përcaktimeve të bëra ftesën për ofertë bazuar në Kushtet e Përgjithshme të Kontratës neni 24.1 Likuidimi i dëmeve për dorëzimin e vonuar pika a e DST vlera e kontratës 785,000 lekë x 5 ditë vonesa x 4/000 lekë për ditë vonesë baras në vlerën **15,700 lekë**, pa TVSH, e cila përbën dëm ekonomik, shkaktuar ndaj buxhetit të Bashkisë Shijak dhe detyrim për arkëtim nga përfituesi.

**Rekomandim:** Drejtoria e Financës të kontabilizojë dhe të marrë masa për arkëtimin e detyrimit nga subjekti “██████████” në vlerën **15,700 lekë**.

**Brenda datës 30.06.2016**

**14. Gjetje nga auditimi:** Me urdhër shpenzimin nr. 80, datë 23.04.2015 për llogari të subjektit “██████████” është kryer pagesë për blerje pajisje për Qendrën Multifunktionale, për të cilin nuk është aplikuar sanksion për 6 ditë vonesa në dorëzimin e materialeve sportive sipas përcaktimeve të bëra ftesën për ofertë bazuar në Kushtet e Përgjithshme të Kontratës neni 24.1 Likuidimi i dëmeve për dorëzimin e vonuar pika a e DST vlera e kontratës 597,200 lekë x 6 ditë vonesa x 4/000 lekë për ditë vonesë baras në vlerën **14,333 lekë**, pa TVSH, e cila përbën dëm ekonomik, shkaktuar ndaj buxhetit të Bashkisë Shijak dhe detyrim për arkëtim nga përfituesi.

**Rekomandim:** Drejtoria e Financës të kontabilizojë dhe të marrë masa për arkëtimin e detyrimit nga subjekti “██████████” në vlerën **14,333 lekë**.

**Brenda datës 30.06.2016**

**15. Gjetje nga auditimi:** Me urdhër shpenzimin nr. 129, datë 10.06.2015 për llogari të subjektit “██████████” është kryer pagesë për rikonstruksionin e Qendrës Multifunktionale, për të cilin nuk është aplikuar sanksion për 7 ditë vonesa në dorëzimin e punimeve sipas përcaktimeve të bëra ftesën për ofertë bazuar në Kushtet e Përgjithshme të Kontratës neni 24.1 Likuidimi i dëmeve për dorëzimin e vonuar pika a e DST vlera e kontratës 490,000 lekë x 7 ditë vonesa x 4/000 lekë për ditë vonesë baras në vlerën **13,720 lekë**, pa TVSH, e cila përbën dëm ekonomik, shkaktuar ndaj buxhetit të Bashkisë Shijak dhe detyrim për arkëtim nga përfituesi.

**Rekomandim:** Drejtoria e Financës të kontabilizojë dhe të marrë masa për arkëtimin e detyrimit nga subjekti “██████████” në vlerën **13,720 lekë**.

**Brenda datës 30.06.2016**

**16. Gjetje nga auditimi:** Me urdhër shpenzimin nr. 258, datë 29.09.2015 për llogari të subjektit “██████████” është kryer pagesë për rikonstruksionin e Zyrave të Bashkisë, për të cilin nuk është aplikuar sanksion për 4 ditë vonesa në dorëzimin e punimeve sipas përcaktimeve të bëra ftesën për ofertë bazuar në Kushtet e Përgjithshme të Kontratës neni 24.1 Likuidimi i dëmeve për dorëzimin e vonuar pika a e DST vlera e kontratës 675,000 lekë x 4 ditë vonesa x 4/000 lekë për ditë vonesë baras në vlerën **10,800 lekë**, pa TVSH, e cila përbën dëm ekonomik, shkaktuar ndaj buxhetit të Bashkisë Shijak dhe detyrim për arkëtim nga përfituesi.

**Rekomandim:** Drejtoria e Financës të kontabilizojë dhe të marrë masa për arkëtimin e detyrimit nga subjekti “██████████” në vlerën **10,800 lekë**.

**Brenda datës 30.06.2016**

**17. Gjetje nga auditimi:** Me urdhër shpenzimin nr. 148, datë 12.09.2014 për llogari të subjektit “██████████” është kryer pagesë për riparimin e kolektorit të pastrimit të



Ujrave të zeza, për të cilin nuk është aplikuar sanksion për 7 ditë vonesa në dorëzimin e mallit dhe të punimeve sipas përcaktimeve të bëra nenin 5 të kontratës bazuar në Kushtet e Përgjithshme të Kontratës neni 24.1 Likuidimi i dëmeve për dorëzimin e vonuar pika a e DST vlera e kontratës 347,555 lekë x 7 ditë vonesa x 4/000 lekë për ditë vonesë baras në vlerën **9,732 lekë**, pa TVSH, e cila përbën dëm ekonomik, shkaktuar ndaj buxhetit të Bashkisë Shijak dhe detyrim për arkëtim nga përfituesi.

**Rekomandim:** Drejtoria e Financës të kontabilizojë dhe të marrë masa për arkëtimin e detyrimit nga subjekti "██████████" në vlerën **9,732 lekë**.

**Menjëherë**

**18. Gjetje nga auditimi:** Me urdhër shpenzimin nr. 23, datë 19.02.2015 për llogari të subjektit "██████████" është kryer pagesë për blerje materiale elektrike, për të cilin nuk është aplikuar sanksion për 4 ditë vonesa në dorëzimin e materialeve elektrike sipas përcaktimeve të bëra ftesën për ofertë bazuar në Kushtet e Përgjithshme të Kontratës neni 24.1 Likuidimi i dëmeve për dorëzimin e vonuar pika a e DST vlera e kontratës 598,000 lekë x 4 ditë vonesa x 4/000 lekë për ditë vonesë baras në vlerën **9,568 lekë**, pa TVSH, e cila përbën dëm ekonomik, shkaktuar ndaj buxhetit të Bashkisë Shijak dhe detyrim për arkëtim nga përfituesi.

**Rekomandim:** Drejtoria e Financës të kontabilizojë dhe të marrë masa për arkëtimin e detyrimit nga subjekti "██████████" në vlerën **9,568 lekë**.

**Menjëherë**

**19. Gjetje nga auditimi:** Me urdhër shpenzimin nr. 413, datë 18.12.2015 për llogari të subjektit "██████████" është kryer pagesë për shtrim rruge në fshatin Shetel të Njësisë Administrative Gjepalaj, për të cilin nuk është aplikuar sanksion për 3 ditë vonesa në dorëzimin e punimeve sipas përcaktimeve të bëra nenin 2 të kontratës bazuar në Kushtet e Përgjithshme të Kontratës neni 24.1 Likuidimi i dëmeve për dorëzimin e vonuar pika a e DST vlera e kontratës 540,000 lekë x 3 ditë vonesa x 4/000 lekë për ditë vonesë baras në vlerën **6,480 lekë**, pa TVSH, e cila përbën dëm ekonomik, shkaktuar ndaj buxhetit të Bashkisë Shijak dhe detyrim për arkëtim nga përfituesi.

**Rekomandim:** Drejtoria e Financës të kontabilizojë dhe të marrë masa për arkëtimin e detyrimit nga subjekti "██████████" në vlerën **6,480 lekë**.

**Brenda datës 30.06.2016**

**20. Gjetje nga auditimi:** Me urdhër shpenzimin nr. 52, datë 01.04.2015 për llogari të subjektit "██████████" është kryer pagesë për blerje materiale sportive, për të cilin nuk është aplikuar sanksion për 2 ditë vonesa në dorëzimin e materialeve sportive sipas përcaktimeve të bëra ftesën për ofertë bazuar në Kushtet e Përgjithshme të Kontratës neni 24.1 Likuidimi i dëmeve për dorëzimin e vonuar pika a e DST vlera e kontratës 621,000 lekë x 2 ditë vonesa x 4/000 lekë për ditë vonesë baras në vlerën **4,968 lekë**, pa TVSH, e cila përbën dëm ekonomik, shkaktuar ndaj buxhetit të Bashkisë Shijak dhe detyrim për arkëtim nga përfituesi.

**Rekomandim:** Drejtoria e Financës të kontabilizojë dhe të marrë masa për arkëtimin e detyrimit nga subjekti "██████████" në vlerën **4,968 lekë**.

**Menjëherë**

**21. Gjetje nga auditimi:** Me urdhër shpenzimin nr. 132, datë 06.08.2014 për llogari të subjektit "██████████" është kryer pagesë për ndërtim dhe riparime në objektin "Shkolla Dollaku", për të cilin nuk është aplikuar sanksion për 3 ditë vonesa në dorëzimin e mallit dhe të punimeve sipas përcaktimeve të bëra nenin 5 të kontratës bazuar në Kushtet e

Përgjithshme të Kontratës neni 24.1 *“Likuidimi i dëmeve për dorëzimin e vonuar”* pika a e DST vlera e kontratës 363,000 leke x 3 ditë vonesa x 4/000 lekë për ditë vonesë baras **4,356 lekë**, pa TVSH, e cila përbën dëm ekonomik, shkaktuar ndaj buxhetit të Bashkisë Shijak dhe detyrim për arkëtim nga përfituesi.

**Rekomandim:** Drejtoria e Financës të kontabilizojë dhe të marrë masa për arkëtimin e detyrimit nga subjekti “**██████████**” në vlerën **4,356 lekë**.

**Menjëherë**

**22. Gjetje nga auditimi:** Me urdhër shpenzimin nr. 80, datë 14.05.2014 për llogari të nxënësve të dalluar për vitin 2013, është kryer pagesë për 10 nxënës të dalluar të gjimnazit 16 Shtatori konfirmuar nga Drejtoria Arsimore Rajonale Durrës me shkresën nr.290/7, datë 05.02.2014 nga 4,000 lekë secili, pa aplikuar tatimin në burim në vlerën **4,000 lekë** e cila përbën dëm ekonomik, shkaktuar ndaj buxhetit të Bashkisë Shijak, pasi bie në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 *“Për tatimin mbi të ardhurat”* i ndryshuar.

**Rekomandim:** Drejtoria e Financës të kontabilizojë dhe të marrë masa për arkëtimin e detyrimit për tatimin në burim nga nga 10 persona në vlerën **4,000 lekë**.

**Brenda datës 30.06.2016**

**23. Gjetje nga auditimi:** Me urdhër shpenzimin nr. 195, datë 13.11.2014 për llogari të subjektit “**██████████**” është kryer pagesë për blerje çakull, për të cilin nuk është aplikuar sanksion për 5 ditë vonesa në dorëzimin e çakullit sipas përcaktimeve të bëra ftesën për ofertë bazuar në Kushtet e Përgjithshme të Kontratës neni 24.1 Likuidimi i dëmeve për dorëzimin e vonuar pika a e DST vlera e kontratës 181,500 lekë x 5 ditë vonesa x 4/000 lekë për ditë vonesë baras në vlerën **3,630 lekë**, pa TVSH, e cila përbën dëm ekonomik, shkaktuar ndaj buxhetit të Bashkisë Shijak dhe detyrim për arkëtim nga përfituesi.

**Rekomandim:** Drejtoria e Financës të kontabilizojë dhe të marrë masa për arkëtimin e detyrimit nga subjekti “**██████████**” në vlerën **3,630 lekë**.

**Menjëherë**

**24. Gjetje nga auditimi:** Me urdhër shpenzimin nr. 149, datë 12.09.2014 për llogari të subjektit “**██████████**” është kryer pagesë e situacionit për objektin *“Rikonstruksion i rrugës Gani Keta dhe sheshit para Kinemasë Shijak”*, sipas kontratës së punimeve datë 31.07.2014, faturës nr.49 datë 11.09.2014.

Nga krahasimi i volumit të punimeve të situacionuara dhe të paguara rezulton se zëri 3.87/b *“Gërmim dheu me eskavator me goma, 0,25 m<sup>3</sup>, në kanale gjerësi mbi 2 m, tokë e zakonshme, kategori e tretë me shkarkim në tokë”* është situacionuar dhe paguar sasia 185 m<sup>3</sup> ndërsa në zërin nr.3.158/3a *“Transport dheu me auto deri në 3 km”* është situacionuar dhe paguar sasia 200 m<sup>3</sup> d.m.th. rezulton se operatori ekonomik ka përfituar më tepër vlerën **3,450 lekë**, pa TVSH, për transport dheu me auto në sasinë prej 15m<sup>3</sup>x230 lekë/m<sup>3</sup>. Veprimet e mësipërme përbëjnë shkelje të kërkesave të ligjit nr.8402, datë 10.09.1998 *“Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”* i ndryshuar dhe dëm ekonomik i cili duhet të arkëtohet nga përfituesi.

**Rekomandim:** Drejtoria e Financës të kontabilizojë dhe të marrë masa për arkëtimin e detyrimit nga subjekti “**██████████**” në vlerën **3,450 lekë**.

**Menjëherë**

**25. Gjetje nga auditimi:** Me urdhër shpenzimin nr. 137, datë 15.06.2015 për llogari të subjektit “**██████████**” është kryer pagesë për blerje shtypshkrime e kancelari, për të cilin nuk është aplikuar sanksion për 7 ditë vonesa në dorëzimin e punimeve sipas përcaktimeve

të bëra ftesën për ofertë bazuar në Kushtet e Përgjithshme të Kontratës neni 24.1 Likuidimi i dëmeve për dorëzimin e vonuar pika a e DST vlera e kontratës 113,960 lekë x 7 ditë vonesa x 4/000 lekë për ditë vonesë baras në vlerën **3,191 lekë**, pa TVSH, e cila përbën dëm ekonomik, shkaktuar ndaj buxhetit të Bashkisë Shijak dhe detyrim për arkëtim nga përfituesi.

**Rekomandim:** Drejtoria e Financës të kontabilizojë dhe të marrë masa për arkëtimin e detyrimit nga subjekti "██████████" në vlerën **3,191 lekë**.

**Menjëherë**

### **C. MASA DISIPLINORE**

Mbështetur në nenin 15, të ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*", nenin 58, germa a, b, c, ç, "*Llojet e masave disiplinore*" dhe nenin 59 "Kompetencat dhe procedurat për masat disiplinore" të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 "*Për Nëpunësin Civil*" dhe akteve nënligjore të dalë në zbatim të tij si dhe mbështetur në kreun IV, neni 11, germa "e" dhe "ç" dhe nenit 37 të ligjit nr. 7691, datë 12.07.1995 "*Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar dhe kontratës individuale të punës, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Shijak, fillimin e procedurave e masave disiplinore: "*Vërejtje*" deri në "*Largim nga Shërbimi Civil*" për:

#### **1. P.A.** me detyrë Drejtore e Financës dhe Nëpunës Zbatues.

-Nuk ka respektuar procedurat për paraqitjen e kërkesave buxhetore dhe kërkesave shtesë sipas programit tek Nëpunësi Autorizues i NjQV-së, brenda datës 15 Maj 2014.

-Nuk ka paraqitur PBA-në për periudhën 2015-2017, në Ministrinë e Financave brenda muajit Qershor.

-Projekt-buxhetet për vitet 2014-2015, janë miratuar jashtë afatit ligjor, në kundërshtim me nenin 32, "*Përgatitja dhe miratimi i buxhetit vendor*" të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*".

-Për muajt Korrik-Gusht ka kryer pagesat e punonjësve të ish Komunave si punonjës të njësive administrative, ndërkohë që emërimet për këta punonjës janë bërë në muajin Shtator për njësitë administrative Maminas dhe Xhafzotaj dhe në muajin Tetor për Njësinë Gjepalaj.

Për muajt Korrik-Gusht ka kryer pagesat e punonjësve të ish Komunave, të cilëve edhe pse ju ishin ndërprerë marrëdhëniet e punës dhe pagës, nga ana e sektorit të financës pagesa për punonjësit e pushuar nuk është bërë në formën e shpërblimit, bazuar në nenin 143 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 "*Kodi i Punës i RSH*", kanë të drejtën e përfitimit të shpërblimit në bazë të vjetërsisë në punë, por ata kanë vazhduar të paguhen edhe në muajt e tjerë me listë prezencë dhe për ditë të plota pune duke ju mbajtur edhe ndalesat për sigurime shoqërore/shëndetësore dhe ndalesat për tatimin.

-Për **shpërndarjen** e orëve të punës së rojeve, duke sjellë si pasojë përdorimin jo me efektivitet të fondeve të Bashkisë Shijak për orë suplementare vetëm për ditët e diela, për më tepër që shërbimi me roje nuk ishte mbuluar edhe për ditët e shtuna. Nëse do të përdoreshin këto fonde me ekonomikitet, në Bashkinë Shijak mund të punësohej edhe një punonjës tjetër me pagë neto në shumën 23.408 lekë/muaj (561.790 / 2 vite/ 12 muaj) .

- Për mangësitë në dokumentacionin bashkëlidhur urdhrave të shpenzimit të bankës për blerjet me vlera të vogla ku mungonte kërkesa për blerjen e mallit ose kryerjen e shërbimit nga Sektorët përkatës të miratuar nga Nëpunësi Autorizues.

-Për mangësitë e konstatuara në kryerje pagesash për blerje në vlera të vogla apo kryerje shërbimesh dhe aktivitete të ndryshme me tejkalim limitesh mbi vlerat e lejuara në vit për një artikull ose grup artikujsh.

-Për mos ndjekjen e zbatimit të afateve të kontratave të sipërmarrjes për punë, shërbime publike dhe mallra dhe mos aplikimin e sanksioneve për ditë vonesa në dorëzimin e punimeve/shërbimeve/mallrave sipas përcaktimeve të bëra nenin 2 të kontratës bazuar në Kushtet e Përgjithshme të Kontratës neni 24.1 Likuidimi i dëmeve për dorëzimin e vonuar pika “a” e DST.

-Për pagesën e subjektit “Në krahët e shpresës”, për sponsorizim aktiviteti “Miss dhe Mister Shijaku 2015”, në vlerën 800,000 lekë, veprim në kundërshtim kërkesat e ligjit nr.7892, datë 21.12.1994 “Për sponsorizimin”.

-Gjatë auditimit të dokumenteve të bankës, u konstatuan në mjaft raste të kryerje së prokurimit të fondeve publike disa mangësi në drejtim të moszbatimit të urdhrit të Ministrisë së Financave nr. 33, datë 11.7.2013 “Për gjurmët standarde të auditit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë”, i hartuar në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM nr. 1, datë 10.1.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, nenin 43 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe nenet 15 e 22 të ligjit 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar e kontrollin” e konkretisht:

- Mungonte kërkesa e argumentuar nga sektorët e interesuar për kryerjen e shpenzimit brenda limitit që përcakton ligji të blerjet me vlera të vogla;

- Nuk ishin përcaktuar sipas rastit specifikimet teknike të shërbimit, apo mallit që do të blihej;

- Nuk evidentohet ngritja e grupit për testimin e tregut dhe as çmimet e marra për bazë në llogaritjen e fondit limit;

- Në disa raste në urdhër prokurimet nuk është argumentuar fondi limit.

- Për mos evidentimin në procesverbalet e nxjerrjes jashtë përdorimit dhe asgjësimit të vlerave materiale të viteve në përdorim të inventarit, amortizimin e llogaritur në vite, vlerën e mbetur, vlerësimi i kostos përfshirë dhe shitjen për skrap të materialeve që mund të përfitohen duke i ndarë ato nga materialet që do të asgjësohen.

-Për pagesën e subjektit “██████████” Dega Shijak për detyrimin për kamatëvonesa të likuidimit të shpenzimeve telefonike në vlerën 20,792,70 lekë.

-Për mangësitë e konstatuara në ndjekjen dhe zbatimin e kontratave të dhënies me qira të pasurive të bashkisë, nga ku u konstatua se për një rast ka mungesë dokumentacioni për objektin e dhënë me qira për “██████████” dhe për një rast ka mosaplikim të tarifës përkatëse të qirasë së truallit për truallin e dhënë me qira për “██████████”.

**2. D.D.** me detyrë ekonomiste dhe në cilësinë e Kryetarit të komisionit të blerjeve me vlera të vogla,

3. **S.B.** me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Taksave Vendore dhe në cilësinë e anëtarit të komisionit të blerjeve me vlera të vogla, për arsye se:
4. **E.O.** me detyrë juriste dhe në cilësinë e anëtarit të komisionit të blerjeve me vlera të vogla dhe ndjekëses të zbatimit të kontratave të qirasë,
5. **H.K.** me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve dhe në cilësinë e anëtarit të komisionit të blerjeve me vlera të vogla,
6. **J.G.** me detyrë inxhinierë dhe në cilësinë e anëtarit të komisionit të blerjeve me vlera të vogla,
7. **S.H.** me detyrë arkitekte dhe në cilësinë e anëtarit të komisionit të blerjeve me vlera të vogla, për arsye se:

- Për mangësitë në dokumentacionin bashkëlidhur urdhrave të shpenzimit të bankës për blerjet me vlera të vogla ku mungonte kërkesa për blerjen e mallit ose kryerjen e shërbimit nga Sektorët përkatës të miratuar nga Nëpunësi Autorizues.

-Për mangësitë e konstatuara në kryerje pagesash për blerje në vlera të vogla apo kryerje shërbimesh dhe aktivitete të ndryshme me tejkalim limitesh mbi vlerat e lejuara në vit për një artikull ose grup artikujsh.

-Për mos ndjekjen e zbatimit të afateve të kontratave të sipërmarrjes për punë, shërbime publike dhe mallra dhe mos aplikimin e sanksioneve për ditë vonesa në dorëzimin e punimeve/shërbimeve/mallrave sipas përcaktimeve të bëra nenin 2 të kontratës bazuar në Kushtet e Përgjithshme të Kontratës neni 24.1 Likuidimi i dëmeve për dorëzimin e vonuar pika a e DST.

-Për pagesën e subjektit ■■■, për sponsorizim aktiviteti “Miss dhe Misster Shijaku 2015”, në vlerën 800,000 lekë, veprim në kundërshtim kërkesat e ligjit nr.7892, datë 21.12.1994 “Për sponsorizimin”.

-Gjatë auditimit të dokumenteve të bankës, u konstatuan në mjaft raste të kryerje së prokurimit të fondeve publike disa mangësi në drejtim të moszbatimit të urdhrit të Ministrisë së Financave nr. 33, datë 11.7.2013 “Për gjurmët standarde të auditit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë”, i hartuar në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM nr. 1, datë 10.1.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, nenin 43 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe nenet 15 e 22 të ligjit 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar e kontrollin” e konkretisht:

- Mungonte kërkesa e argumentuar nga sektorët e interesuar për kryerjen e shpenzimit brenda limitit që përcakton ligji të blerjet me vlera të vogla;

- Nuk ishin përcaktuar sipas rastit specifikimet teknike të shërbimit, apo mallit që do të blihej;

- Nuk evidentohet ngritja e grupit për testimin e tregut dhe as çmimet e marra për bazë në llogaritjen e fondit limit;

- Në disa raste në urdhër prokurimet nuk është argumentuar fondi limit.

-Për mangësitë e konstatuara në ndjekjen dhe zbatimin e kontratave të dhënies me qira të pasurive të bashkisë, nga ku u konstatua se për një rast ka mungesë dokumentacioni për objektin e dhënë me qira për ■■■ dhe për një rast ka mos aplikim të tarifës përkatëse të qirasë së truallit për truallin e dhënë me qira për “■■■”

#### **D. MASA ADMINISTRATIVE:**

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve publike në nenet 4, 12, 19/7, 21, 23, 25, 28, 38, 39, 40, 41, 42, 43, 53, 56, 63, etj, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në procesverbalet nr. datë 09.02.2016, vërejtjeve komentet e subjektit të audituar dhe pjesës së Raportit përfundimtar të auditimit.

Mbështetur në nenet 13 dhe 72 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative” dhe bazuar në nenin 15 shkronja (c dhe ç) dhe nenin 30 të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Prokurimit Publik**, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave administrative (dënim me gjobë) në raport me shkeljet e konstatuara në 12 procedurat e prokurimeve publike, apo rekomandimin e Autoritetit Kontraktor (për marrjen e masave disiplinore), ndaj **punonjësve dhe ish punonjësve** si më poshtë:

- 1. SH.D.** me detyrë Nën Kryetare e Bashkisë në cilësinë e kryetarit të KVO,
- 2. S.B.** me detyrë Përgj. Sektori i Taksave Vendore, në cilësinë e anëtarit të KVO,
- 3. J.G.** me detyrë Përgj. Sektori Planifikimit, Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit, në cilësinë e anëtarit të KVO.

I. Në tenderin e zhvilluar me objekt *“Rehabilitim i qendrës së qytetit Shijak”*, kanë skualifikuar dhe kualifikuar padrejtësisht operatorët ekonomik në kushtet kur nuk përmbushin disa nga kriteret e veçanta të kualifikimit, në kundërshtim me VII, neni 66, pika 3 të Vendimit nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*.

a. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave.

II. Në tenderin e zhvilluar me objekt *“Rikonstruksion i rrugës Mihal Mihali”*, kanë skualifikuar dhe kualifikuar padrejtësisht operatorët ekonomik në kushtet kur nuk përmbushin disa nga kriteret e veçanta të kualifikimit, në kundërshtim me VII, neni 66, pika 3 të Vendimit nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*.

III. Në tenderin e zhvilluar me objekt *“Rikonstruksion i rrugës Sallmone dhe rrugës Bregu i lumit”*, kanë skualifikuar dhe kualifikuar padrejtësisht operatorët ekonomik në kushtet kur nuk përmbushin disa nga kriteret e veçanta të kualifikimit, në kundërshtim me VII, neni 66, pika 3 të Vendimit nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*.

IV. Në tenderin e zhvilluar me objekt *“Mbikëqyrje punimesh në objektin Rehabilitim i qendrës së qytetit Shijak”*, kanë skualifikuar dhe kualifikuar padrejtësisht operatorët ekonomik në kushtet kur nuk përmbushin disa nga kriteret e veçanta të kualifikimit, në kundërshtim me VII, neni 66, pika 3 të Vendimit nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*.

V. Në tenderin e zhvilluar me objekt *“Blerje ushqime për kopsht e çerdhe”*, kanë skualifikuar dhe kualifikuar padrejtësisht operatorët ekonomik në kushtet kur nuk përmbushin disa nga kriteret e veçanta të kualifikimit, në kundërshtim me VII, neni 66, pika 3 të Vendimit nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*.

VI. Në tenderin e zhvilluar me objekt *“Mobilim e zyrave të Bashkisë Shijak”*, kanë skualifikuar dhe kualifikuar padrejtësisht operatorët ekonomik në kushtet kur nuk përmbushin disa nga kriteret e veçanta të kualifikimit, në kundërshtim me VII, neni 66, pika 3 të Vendimit nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*.

a. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave.

**4. SH.D.** me detyrë Nën Kryetare e Bashkisë në cilësinë e kryetarit të KVO,

**5. P.A.** me detyrë Përgj. Sektori i Financës, në cilësinë e anëtarit të KVO,

**6. S.H.** me detyrë arkitekte, në cilësinë e anëtarit të KVO,

VII. Në tenderin e zhvilluar me objekt *“Grumbullim i mbeturinave të fshatrave dhe mirëmbajtje e sipërfaqeve të gjelbëruara në Komunën Xhafzotaj”*, kanë skualifikuar dhe kualifikuar padrejtësisht operatorin ekonomik në kushtet kur nuk përmbush disa nga kriteret e veçanta të kualifikimit, në kundërshtim me VII, neni 66, pika 3 të Vendimit nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*.

**7. A.G.** me detyrë specialist në cilësinë e kryetarit të KVO,

**8. F.H.** me detyrë inxhinier, në cilësinë e anëtarit të KVO,

**9. L.A.** me detyrë ekonomiste, në cilësinë e anëtarit të KVO,

**10. E.O.** me detyrë jurist në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit:

**11. M.D.** me detyrë inxhinier në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit:

**12. S.M.** me detyrë ekonomiste në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit:

Në tenderin e zhvilluar me objekt **“Grumbullim i mbeturinave të fshatrave dhe mirëmbajtje e sipërfaqeve të gjelbëruara në Komunën Xhafzotaj”**, nuk është i dokumentuar argumentimi i llogaritjes së vlerës së kontratës, veprime këto në kundërshtim me kreun VII, neni 59, pikat 1, 2, shkronjat a, b, c të Vendimit nr. 914, datë 29.12.2014 **“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”**, si dhe nuk është respektuar parimi i mos diskriminimit, duke vendosur kërkesa specifike, që nuk mundësojnë pjesëmarrje të gjerë të operatorëve, veprimet këto në kundërshtim me kreun III neni 20 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 **“Për Prokurimin Publik”** i ndryshuar.

VIII. Në tenderin e zhvilluar me objekt **“Ndërtim i rrjetit sekondar të kanalizimit të fshatit Hardhishtë, Komuna Gjepalaj”**, kanë skualifikuar dhe kualifikuar padrejtësisht operatorin ekonomik në kushtet kur nuk përmbush disa nga kriteret e veçanta të kualifikimit, në kundërshtim me VII, neni 66, pika 3 të Vendimit nr. 914, datë 29.12.2014 **“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”**.

**13. E.R.** me detyrë specialiste në cilësinë e kryetarit të KVO,

**14. D.S.** me detyrë specialist taksave vendore, në cilësinë e anëtarit të KVO,

**15. L.S.** me detyrë përgjegjëse finance, në cilësinë e anëtarit të KVO,

**16. K.Ç.** me detyrë juriste në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit:

**17. L.V.** me detyrë inspektor i tokave në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit:

Në tenderin e zhvilluar me objekt **“Ndërtim i rrjetit sekondar të kanalizimit të fshatit Hardhishtë, Komuna Gjepalaj”**, nuk është i dokumentuar argumentimi i llogaritjes së vlerës së kontratës, veprime këto në kundërshtim me kreun VII, neni 59, pikat 1, 2, shkronjat a, b, c të Vendimit nr. 914, datë 29.12.2014 **“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”**, si dhe nuk është respektuar parimi i mos diskriminimit, duke vendosur kërkesa specifike, që nuk mundësojnë pjesëmarrje të gjerë të operatorëve, veprimet këto në kundërshtim me kreun III neni 20 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 **“Për Prokurimin Publik”** i ndryshuar.

IX. Në tenderin e zhvilluar me objekt **“Blerje karburanti (Gazoil D1), Komuna Gjepalaj”**, kanë skualifikuar dhe kualifikuar padrejtësisht operatorin ekonomik në kushtet kur nuk përmbush disa nga kriteret e veçanta të kualifikimit si dhe nuk është respektuar parimi i mos diskriminimit, duke vendosur kërkesa specifike, që nuk mundësojnë pjesëmarrje të gjerë të operatorëve, në kundërshtim me kreun III neni 20 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 **“Për Prokurimin Publik”** i ndryshuar, kreun VII, neni 59, pikat 1, 2, shkronjat a, b, c dhe neni 66, pika 3 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 **“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”**.

X. Në tenderat e zhvilluar me objekt: **“Rikonstruksion i Kopshtit të Fëmijëve në fshatin Karpen”**, **“Rikonstruksion i rrugëve të fshatit Maminas me Rërë Bituminoze”** dhe **“Rikonstruksion i Kabinës Elektrike në fshatin Gjecaj të Komunës Maminas”**,

**18. R.D.** me detyrë inxhinier në cilësinë e Kryetarit të KVO,

**19. A.S.** me detyrë ekonomist në cilësinë e anëtarit të KVO,

**20. R.M.D.** me detyrë specialist në cilësinë e anëtarit të KVO,

**21. D.D.** me detyrë specialiste në cilësinë e anëtarit të KVO,

**22. B.D.** me detyrë jurist në cilësinë e Njesisë së Prokurimit,

**23. F.D.** me detyrë ekonomiste në cilësinë e Njesisë së Prokurimit,

**24. M.T.** me detyrë inxhinierë në cilësinë e Njesisë së Prokurimit,



Pasi për të tri procedurat nga ana e Njesisë së Hartimit të Dokumenteve u është bërë ftesë operatorëve ekonomik, pa asnjë argumentim se si janë përzgjedhur këta operator ekonomik, çfarë aktiviteti tregtar ushtrojnë dhe ku e ushtrojnë, kur nga shqyrtimi në QKR i aktiviteteve të subjekteve rezulton se nuk kanë eksperiencë në fushën e prokurime që kërkohet të realizohen, si dhe nuk kanë ndjekur të gjitha procedurat pasi Raporti përmbledhës drejtuar kryetarit nuk ka të referuar elementet e procedurës në të gjitha hapat e saj, mungon procesverbali i procedurës së prokurimi, etj. në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar dhe VKM nr. 1, datë 10.1.2007 “Për rregullat e prokurimit Publik”.

#### **E. PËR PUNONJËSIT E LARGUAR DHE NUK KANË ADRESË**

Për punonjësit e larguar nga puna të ish Komunave Gjepalaj, Maminas dhe Xhafzotaj nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimit të tyre.

*Në kushtet kur mos ushtrimi i detyrës administrative nga ana e punonjësve ka ndikuar në funksionimin administrativ të institucionit, për këtë ngarkohet që Bashkia të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për rezultatet e auditimit të KLSH për këta persona dhe marrjen e masave të mëtejshme nga ana e saj.*

#### **F. TË TJERA**

Auditimi i kryer në Bashkinë Shijak dhe 3 ish komunit (aktualisht njësi administrative), respektivisht Maminas, Xhafzotaj dhe Gjepalaj, vlerësohet dobët nga Kryetari i KLSH-së për sa i përket problemeve të trajtuara nga grupi i auditimit dhe për të kontrolluar cilësinë e punës audituese, do të riauditohet në një kohë të dytë.

*Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor dhe Departamenti Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës.*

**Bujar LESKAJ**

**K R Y E T A R**